



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:084427

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06163787

KPPP.nr. 501/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit RS Computers L.L.C., me numër unik identifikues 810142307 dhe seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci”, nr. 20, kundër debitorit PMC Engineering L.L.C., me numër unik identifikues 811952325 dhe seli në Prishtinë, rr. “Nazim Gafurri”, 240, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 127/24 të datës 28.02.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.09.2024 merr këtë.

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit PMC Engineering L.L.C., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 127/24 i datës 28.02.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, sa i përket detyrimit në shumë prej EUR 500.00.
- II. REFUZHET pjesërisht prapësimi i debitorit PMC Engineering L.L.C., ashtu që MBETET NË FUQI pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 127/24 i datës 28.02.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, sa i përket detyrimit në shumë prej EUR 1,207.00.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit RS Computers L.L.C., me datë 28.02.2024 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 127/24 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: Faturës nr. 23-SHV01-001-161, e datës 01.12.2023; Faturës nr. 23-SHV01-001-167, e datës 07.12.2023 dhe Faturës nr. 24-SHV01-001-11, e datës 22.01.2024, duke urdhëruar debitorin t’i paguaj kreditorit borxhin e papaguar nga faturat e lartcekura në

shumë prej 1,707.00 EUR € (një mijë e shtatëqind e shtatë euro), me kamatë ligjore prej 8% prej rënies në vonesë e deri në pagesën definitive të borxhit kryesor, si dhe shpenzimet e procedurës.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kontestuar urdhrin për përmbarim me arsyetimin se urdhri përmbarimor është lejuar në bazë të dokumenteve që nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme, pasi që faturave i'u mungon nënshkrimi, vula apo protokollimi, andaj edhe nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas dispozitave të LPP-së,

Kreditore, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit për faktin se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë nënshkruar nga kreditore dhe debitori, si dhe për borxhin e pretenduar janë kryer pagesa, mirëpo i njëjti nuk është përmbushur në tërësi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Në mbështetje të dispozitave të cekura si më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi duke anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor për borxhin në lartësi prej EUR 500.00 sipas Faturës nr. 24-SHV01-001-11 e datës 22.01.2024 ngase kjo faturë, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, ndërsa kreditore nuk ka dëshmuar se të njëjtën faturë i'a ka dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ndërsa ky i fundit, e ka pranuar dhe është njoftuar për detyrimin që buron nga kjo faturë.

Andaj, fatura si e tillë rezulton të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe rrjedhimisht nuk është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 1,207.00, ngase lidhur me këtë pjesë të detyrimit, dokumentet e besueshëm përkatësisht Fatura nr. 23-SHV01-001-161 e datës 01.12.2023 dhe Fatura nr. 23-SHV01-001-167, e datës 07.12.2023, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është emërtuar qartë objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Po ashtu, gjykata gjen se të njëjtat fatura janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit ndërsa janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, ashtu që rezulton se i njëjti ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga faturat objekt përmbarimi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e tërësishëm të urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 501/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate